



Co-funded by the  
Erasmus+ Programme  
of the European Union

Universiteti i Tiranës është pjesë e Projektit GRADUA (2017-2020), “*Avancimi i të Diplomuarve dhe zhvillimi i kapaciteteve universitare në Shqipëri (GRaduates Advancement and Development of University capacities in Albania)*”, projekt i financuar nga Komisioni Evropian përmes nismës Erasmus + KA2, i cili synon të mbështetë universitetet shqiptare duke krijuar një sistem të dhënash ndërveprues dhe një model që përputh kërkesën me ofertën e punësimit të të diplomuarve.

Gradua, një projekt për avancimin e të diplomuarve dhe zhvillimin e kapaciteteve universitare në Shqipëri, i cili synon t’u vijë në ndihmë universiteteve shqiptare me anë të krijimit të bazës së të dhënave të të diplomuarve, informacioneve mbi performancën e të diplomuarve, lehtësimin e bashkëpunimit mes institucioneve të arsimit të lartë dhe biznesit, lehtësimin e avancimit të të diplomuarve në tregun e punës, që mbetet një nga shqetësimet më të mëdha të të rinjve sot si dhe krijimit të platformës për përputhjen e kërkesës së tregut të punës dhe ofertës akademike, Në këtë projekt bashkëpunojnë shtatëmbëdhjetë Institucione, mes tyre jo vetëm universitete shqiptare, publike e private, por edhe institucione partnere në Spanjë, Portugali dhe Itali. Projekti koordinohet është Universiteti Bujqësor i Tiranës.

Qëllimi kryesor i këtij projekti do të realizohet nëpërmjet huazimit të modelit të databazës së të diplomuarve, i zhvilluar në Itali, i cili do të mundësojë grumbullimin dhe analizimin e të dhënave mbi performancën e të diplomuarve dhe të universiteteve, lëshimin e dokumentacionit të besueshëm, të vazhdueshëm dhe të azhurnuar për vlerësimin e sistemit të arsimit të lartë në mbështetje të procesit të reformës, lehtësimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë dhe botës së biznesit (shërbimet online të bazuara në TI janë zhvilluar dhe vënë në dispozicion të të diplomuarve, stafit dhe firmave universitare); lehtësimin e vendosjes së të diplomuarve në tregun e punës.

### **Partnerët e projektit GRADUA**

Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT)

Universiteti i Tiranës (UT)

Universiteti i Arteve, Tiranë (UART)

Universiteti Politeknik i Tiranës (PUT)

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë (UMT)

Universiteti European i Tiranës (UET)

Universiteti Polis (U\_POLIS)



Co-funded by the  
Erasmus+ Programme  
of the European Union

Universiteti Katolik “Zonja e Këshillit të Mirë” (UniKZKM)

Albanian University (AU)

Alma Mater Studiorum Università di Bologna (UNIBO)

Università degli Studi di Siena (UNISI)

University of Barcelona (UB)

University Institute of Lisbon (ISCTE-IUL)

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë (ÇIT)

Consorzio Interuniversitario AlmaLaurea (AL)

Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve (MARS)

Associated partners: United Nations Development Programme (UNDP)